

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës
Për: Kryetaren e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Data: 31 gusht 2021
Parashtrues: Mbrojtësi i specializuar
Gjuha origjinale: Anglishte
Klasifikimi: Publik

PROKURORI I SPECIALIZUAR
k.
PJETËR SHALËS

**Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes kundër “Vendimit mbi
kërkesën e Pjetër Shalës për lirim të përkohshëm”**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Z. Xhek Smith

**Mbrojtësi i Specializuar i të
akuzuarit:**
Z. Zhan-Lui Zhilisen
Z. Hedi Auini

I. HYRJE

1. Mbrojtja e z. Pjetër Shala parashtron këtë apel kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që refuzon kërkesën e Pjetër Shalës për lirim të përkohshëm në përputhje me nenet 41(2), 45(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 58(2) dhe 170 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”).¹
2. Mbrojtja parashtron se ekzistojnë nëntë arsye për apel të cilat përbëhen nga: (i) një sërë gabimesh ligjore, përfshirë shkelje të të drejtave themelore të njeriut; (ii) një sërë gabimesh faktike flagrante që çuan në konstatime të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund t’i bënte në mënyrë të arsyeshme mbi bazën e provave; (iii) një sërë rastesh në të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh aspekte të parëndësishme dhe nuk mori parasysh aspekte të rëndësishme; dhe, si pasojë, (iv) një sërë gabimesh të dukshme në ushtrimin e diskrecionit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.
3. Këto gabime, veçazi dhe bashkërisht, çuan në konstatimin e gabuar se vazhdimi i paraburgimit të z. Shalës është i përligjur. Mbrojtja kërkon nga Gjykata e Apelit t’i korrigojë këto gabime dhe të lirojë z. Shala përkohësisht.

II. HISTORIKU PROCEDURAL

4. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën e rishikuar kundër të akuzuarit dhe lëshoi fletarrestim për të.² Më 16 mars 2021,

¹ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi kërkesën e Pjetër Shalës për lirim të përkohshëm, 15 qershor 2021 (konfidencial) (“Vendimi i kontestuar”). Të gjitha referencat e tjera lidhur me parashtrimet në këtë kërkesë lidhen me lëndën nr. KSC-BC-2020-04 përveç nëse përcaktohet ndryshe.

² F000038, Prokurori i Specializuar, Parashtrim i versionit të mëtejshëm me më pak redaktime të Aktakuzës së konfirmuar me shtojcën konfidenciale 1, (konfidencial); F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar konfidencial i vendimit mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimit dhe

me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),³ dhe në vijim të konfirmimit të një aktakuze (“vendimi i konfirmimit”),⁴ z. Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”),⁵ në bazë të vendimit mbi fletarrestim dhe paraburgim, dhe të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁶

5. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁷
6. Më 27 maj 2021, Mbrojtja dorëzoi për protokollim një kërkesë për lirim të përkohshëm të z. Shala (“mocioni”).⁸ Më 9 qershor 2021, ZPS-ja u përgjigj ndaj mocionit (“përgjigja”).⁹ Më 14 qershor 2021, Mbrojtja iu kundërpërgjigj përgjigjes (“kundërpërgjigja”).¹⁰

urdhrit të transferimit, 12 qershor 2020, paragrafët 20-23 (konfidencial) (“Vendimi mbi fletarrestimin dhe paraburgimin”). *Shih gjithashtu* F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar publik i fletarrestimit për z. Shala, 12 qershor 2020 (“Fletarrestimi”); F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar publik i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 12 qershor 2020 (“Urdhri për transferim”).

³ F00002, Prokurori i Specializuar, Version i redaktuar konfidencial i “Parashtrimit të Aktakuzës për konfirmim dhe i kërkesave në lidhje me të”, parashtrimi i protokolluar KSC-BC2020-04/F00002 i datës 14 shkurt 2020 me shtojcën konfidenciale 1, 26 prill 2021.

⁴ F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar konfidencial i vendimit mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 12 qershor 2020 (konfidencial) (“Vendimi i konfirmimit”).

⁵ F00013, Administratorja, Njoftim për arrestimin sipas rregullës 55(4), 16 mars 2021.

⁶ F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrit të transferimit, 12 qershor 2020 (konfidencial) (“Vendimi mbi fletarrestimin dhe paraburgimin”); F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar publik i fletarrestimit për z. Pjetër Shala, 12 qershor 2020 (“Fletarrestimi”).

⁷ F00019, Administratorja, Njoftim për pranimin e Pjetër Shalës në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për caktimin me kusht të mbrojtësit, 15 prill 2021 (konfidencial).

⁸ F00039, Mbrojtja e z. Shala, Mocion për lirim të përkohshëm, 27 maj 2021 (konfidencial).

⁹ F00042, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Pjetër Shala, 9 qershor 2021 (konfidenciale).

¹⁰ F00044, Mbrojtja e z. Shala, Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së Prokurorisë për kërkesën për lirim të përkohshëm, 14 qershor 2021 (konfidenciale).

7. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e refuzoi mocionin.¹¹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Neni 29(2) i kushtetutës së Kosovës përcakton se “çdokush që arrestohet, ka të drejtën të [...] lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit”. Gjithashtu neni përcakton se “askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe [...] kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit.”
9. Neni i 3(2)(3) i Ligjit përcakton se e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, që përcakton standardet e drejtësisë penale, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), ka “përparësi” ndaj dispozitave ligjore të Kosovës përmes nenit 22 të Kushtetutës.
10. Meqenëse vendimi i kontestuar lidhet me vazhdimin e paraburgimit, z. Shala ka të drejtë të apelojë në bazë të nenit 45(2) të Ligjit.¹²
11. Gjykata e Apelit ka konstatuar se standardi i rishikimit në lidhje me apelet e ndërmjetme është i barasvlershëm me standardin e rishikimit të përcaktuar në nenin 46(1) të Ligjit për apelet kundër aktgjykimeve, për arsye të: (i) një gabimi ligjor që e bën aktgjykimin të pavlefshëm; (ii) një gabimi faktik i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë; ose, në lidhje me vendime diskrecionale, (iii) një gabimi të dukshëm, në kuptimin që vendimi është bazuar në një

¹¹ Vendimi i kontestuar, para. 50.

¹² KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Dhoma e Gjykatës së Apelit, Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 15, 18 (“Vendimi i apelit të Gucatit”).

interpretim të gabuar të ligjeve në fuqi, është një përfundim faktik qartësisht i gabuar, ose është aq i padrejtë dhe i paarsyeshëm sa që përbën keqpërdorim diskrecionit.¹³

IV. ARSYET PËR APEL

12. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e refuzoi mocionin, duke konstatuar se: (i) Mbrojtja ka pasur “mundësi të mjaftueshme” për të parashtruar mendimin e saj në lidhje me kundërshtimet e ZPS-së ndaj lirimit të përkohshëm”; (ii) “ekziston rrezik i [moderuar] i arratisjes në rastin e z. Shala, i cili është më i madh se sa thjesht mundësia e materializimit të këtij rreziku”; (iii) ekziston rreziku që z. Shala “do të pengojë ecurinë e procedurave para DHS-së, i cili është më i madh se sa thjesht mundësia e materializimit të këtij rreziku”; (iv) ekziston rreziku që ai “do të kryejë krime të tjera, që është më i madh se sa thjesht mundësia e materializimit të këtij rreziku”; dhe (v) sa i përket rrezikut të pengimit të ecurisë së procedurave para DHS-së ose kryerjes së krimeve të tjera, “asnjë nga kushtet e propozuara, apo çfarëdo kufizimi tjetër shtesë që mund të vendoset nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk mund të kufizojë aftësinë e z. Shala për të pasur qasje në informacion dhe burime të cilat do të mundësonin përpjekjet për të komunikuar me viktimat, familjet e tyre, apo me rrjetin e tij mbështetës;” (vi) “paraburgimi i” z. Shala “vazhdon të jetë proporcional” për shkak të kohëzgjatjes së gjithsejtë të paraburgimit që nga 15 prilli 2021.
13. Z. Shala parashtron se këto konstatime cenohen prej gabimeve të rënda faktike dhe ligjore si dhe nga ushtrimi i padrejtë dhe i paarsyeshëm i diskrecionit. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) nuk vlerësoi dhe nuk pranoi se është bërë shkelje e detyrimit procedural sipas nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit

¹³ KSC-BC-2020-06, IA001-F00005, Dhoma e Apelit, Vendim mbi apelin e Kadri Veselit kundër vendimit lidhur me lirimin e përkohshëm, 30 prill 2021 (“Vendimi i apelit të Veselit”), paragrafët. 4-7; Vendimi i apelit të Gucatit, paragrafët 10-14.

5 të KEDNJ-së, duke marrë parasysh mangësitë procedurale që i pamundësuan Mbrojtjes t'u përgjigjej në mënyrë të efektshme kundërshtimeve të ZPS-së ndaj lirit të përkohshëm; (ii) zbatoi standardin e gabuar në vlerësimin e rrezikut sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit; (iii) gaboi kur konstatoi se z. Shala paraqet rrezik për arratisje; (iv) gaboi kur konstatoi se ekziston rreziku që z. Shala do të pengojë ecurinë e procedurave; (v) gaboi kur konstatoi që z. Shala do të kryejë krime të tjera; (vi) gaboi kur konstatoi që rreziku i pengimit të ecurisë së procedurave para DHS-së ose i kryerjes së krimeve të tjera nuk mund të trajtohej me asnjë kusht të mundshëm për lirim të përkohshëm; (vii) gaboi kur urdhëroi vendosjen në fakt të një "ndalimi të përgjithshëm" mbi lirin e përkohshëm për shkak të shqetësimeve lidhur me mbrojtjen e efektshme të konfidencialitetit të informacionit që u nxirret personave të akuzuar para DHS-së, ndër të cilët edhe z. Shala, duke u hequr kështu të paraburgosurve çfarëdo shprese për lirim të përkohshëm, në kundërshtim me frymën dhe arsyetimin e nenit 46(1) të Ligjit dhe nenit 5 të KEDNJ-së; (viii) bëri vlerësim të gabuar lidhur me proporcionalitetin e paraburgimit; (ix) gaboi kur nuk e shqyrtoi aspak propozimin që z. Shala të vendoset në arrest shtëpiak, një mundësi që mund t'u përgjigjej shqetësimeve që Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të ketë sa i përket rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.

Arsyeja e parë: Mosvlerësimi dhe mospranimi i shkeljes procedurale të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së

14. Dhoma e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Gjykata Kushtetuese") ka nxjerrë përfundimin se çdo heqje lirie duhet të bëhet në përputhje me rregullat materiale dhe procedurale të përcaktuara me ligj dhe në përputhje me qëllimin kryesor të mbrojtjes së individit nga arbitrariteti.¹⁴ Në këtë kontekst, çdo

¹⁴ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim mbi referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 19(5) të Ligjit Nr. 05/L-053 për DHS-të dhe ZPS-në, 26 prill 2017 ("Aktvendimi i DHSGJK-së 26 prill 2017"), para. 111.

kërkesë për lirim të përkohshëm duhet të shqyrtohet duke mbajtur parasysh të drejtën e të akuzuarit për t'u prezumuar i pafajshëm.¹⁵

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk vlerësoi dhe nuk pranoi se është bërë shkelje e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së duke pasur parasysh mangësitë procedurale që privuan Mbrojtjen nga mundësia efektive për t'iu përgjigjur kundërshtimeve të ZPS-së ndaj liritimit të përkohshëm.
16. Sipas nenit 5(4) të KEDNJ-së, personat e arrestuar ose të paraburgosur kanë të drejtën e shqyrtimit në përputhje me garancitë procedurale dhe materiale, përfshirë garancitë e procedurës gjyqësore, që janë thelbësore për "ligjshmërinë" e çdo heqjeje lirie. Rrjedhimisht, procedurat për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit, siç është shqyrtimi i mocionit të Mbrojtjes për lirim të përkohshëm në këtë çështje, duhet të plotësojnë kriteret themelore të gjykimit të drejtë të garantuara në nenin 6 të KEDNJ-së. Ato "duhet të jenë ballafaqese dhe duhet të sigurojnë gjithmonë 'barazinë' midis palëve, prokurorit dhe personit të paraburgosur".¹⁶ Jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") përcakton se "barazia e palëve nuk sigurohet nëse mbrojtësit i mohohet qasja në ato dokumente të dosjes së hetimit që janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë të efektshme ligjshmërinë e paraburgimit të klientit të vet".¹⁷ Është shkelje e parimit të barazisë midis palëve në qoftë se personi që mbahet në paraburgim nuk ka mundësinë të kundërshtojë në mënyrë të efektshme akuzat kundër tij.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, IA001-F00005, Dhoma e Apelit, Vendim mbi apelin e Kadri Veselit kundër vendimit në lidhje me lirimin e përkohshëm, 30 prill 2021, para 14; Aktvendimi i DHSGJK-së 26 prill 2017, para. 113.

¹⁶ ECtHR/GJEDNJ, *Podeschi v. San Marino*, no. 66357/14, 13 prill 2017, para. 171; ECtHR/GJEDNJ, *Mooren v. Germany* [GC], no. 11364/03, 9 korrik 2009, para. 124.

¹⁷ *Mooren v. Germany*, para. 124, dhe jurisprudenca e përmendur aty.

17. Z. Shala u arrestua në bazë të vendimit për fletarrestim dhe paraburgim të lëshuar *ex parte* më 12 qershor 2020. Këto vendime iu bënë atij të ditura më 15 prill 2021, në një formë tejet të redaktuar. Shkalla e redaktimeve në parashtrimet përkatëse të ZPS-së dhe vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake dëmtuan në masë të konsiderueshme aftësinë e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur kundërshtimeve të ZPS-së ndaj lirimit të përkohshëm. Kjo u bë deri në atë masë sa që shkeli të drejtën e z. Shala për të mos iu hequr liria në mënyrë arbitrare, sikurse garantohet nga legjislacioni i Kosovës dhe ai ndërkombëtar në fuqi.
18. ZPS-ja pranoi se redaktimet e konsiderueshme nuk ishin të nevojshme gjatë kohës që shqyrtohej mocioni i z. Shala për lirim të përkohshëm dhe, në përgjigjen e vet të 9 qershorit 2021, kërkoi që vendimi mbi fletarrestimin dhe parashtrimi i Aktakuzës për konfirmim dhe i kërkesave në lidhje me të, të riklasifikoheshin nga rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte* në konfidencialë.¹⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e miratoi këtë kërkesë dhe Mbrojtja u njoftua përmes postës elektronike lidhur me urdhrin i tij të premtën, më 11 qershor 2021, ndërsa afati për dorëzimin e kundërpërgjigjes së Mbrojtjes ndaj përgjigjes afrohej dhe përfundonte të hënën, më 14 qershor 2021. Mbrojtja mori qasje në të gjithë informacionin përkatës vetëm pas njoftimit të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të 11 qershorit 2021 dhe vetëm pas kësaj date mundi të kuptojë dhe të vlerësojë tërësinë e kundërshtimeve të ZPS-së. Rrjedhimisht, Mbrojtja pati vetëm një ditë pune për t'iu përgjigjur kundërshtimeve të ZPS-së, me vetëm 2,000 fjalë.¹⁹

¹⁸ Përgjigja, numrat 2, 30.

¹⁹ Neni 41 i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara (që përcakton se çdo kundërpërgjigje ndaj përgjigjes nuk duhet të jetë më shumë se 2000 fjalë).

19. Lidhur me ankesën e Mbrojtjes për shkelje procedurale të nenit 5 të KEDNJ-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vërejtë se “Mbrojtja pjesërisht u parapriu argumenteve të ZPS-së dhe iu përgjigj atyre” dhe riklasifikimi i dokumenteve përkatëse i dha Mbrojtjes mundësinë që në kundërpërgjigjen e vet të trajtonte parashtrimet e ZPS-së.²⁰ Sipas mendimit të tij kjo i dha Mbrojtjes mundësi të mjaftueshme “për të parashtruar mendimin e vet” në lidhje me këtë çështje.
20. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte i mendimit se “ZPS-ja e nxori informacionin nën shqyrtim në përgjigjen e saj”.²¹ Në fakt, siç thuhet më lart, edhe pse disa informacione përkatëse u nxorën në përgjigje, Mbrojtja mori qasje të plotë në parashtrimet përkatëse dhe referencat në materialin mbështetës të ofruar nga ZPS-ja, vetëm pas njoftimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi riklasifikimin e urdhrit. Mosshqyrtimi nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shkallës dhe i ndikimit të mosnxjerrjes së informacionit kyç Mbrojtjes është me rëndësi, sepse tregon se ai nuk shqyrtoi shkallën e dëmit që iu shkaktua Mbrojtjes. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi mjaftueshëm rrethanat në të cilat Mbrojtja mund t’i përgjigjej kundërshtimeve të ZPS-së ndaj lirimit të përkohshëm.
21. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i atribuoi në mënyrë të gabuar peshë faktit që Mbrojtja arriti t’u “paraprinte pjesërisht” parashtrimeve të ZPS-së. Aftësia e Mbrojtjes për të hamendësuar verbërisht kundërshtimet e mundshme të ZPS-së nuk mund të barazohet me dijeninë për kundërshtime të tilla dhe pasjen e mundësisë reale për t’iu përgjigjur atyre në mënyrë të efektshme.

²⁰ Vendimi i kontestuar, para. 12.

²¹ Po aty.

22. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e shqyrtoi ankesën për shkelje të të drejtave të Mbrojtjes në lidhje me këtë, me përpikërinë dhe vëmendjen që meriton një ankesë për shkelje të të drejtave themelore.

Arsyeja e dytë: Moszbatimi i standardit të duhur në vlerësimin e rrezikut sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit

23. Neni 29(2) i Kushtetutës së Kosovës përcakton se “çdokush që arrestohet ka të drejtën [...] të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik të konsiderueshëm për ikjen e saj/tij para gjykimit”. Gjithashtu thotë se “askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj [...] kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale, dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit (theksimi i shtuar).”
24. Neni 41(6) i Ligjit përcakton se një i akuzuar mund të paraburgoset kur ka arsye të artikulueshme për të besuar se “ekziston rreziku i arratisjes”; ose “ai ose ajo *do të* [...] pengojë ecurinë e procedurës penale”; ose “[ekziston] rreziku se ai ose ajo *do ta* përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ai ose ajo ka kërcënuar se do ta kryejë. (theksimi i shtuar).”
25. Instrumentet ndërkombëtare në fuqi për të drejtat e njeriut kërkojnë që paraburgimi para gjykimit të urdhërohet vetëm atëherë kur asnjë masë tjetër nuk mund të zvogëlojë një rrezik të identifikuar *qartë dhe real*.²²

²² ECtHR/GJEDNJ, *S., V. and A. v. Denmark* [GC], nr. 35553/12 dhe dy të tjerë, 22 tetor 2018 (“*S., V. and A. v. Denmark*”), para. 77. *Shih* nenin 5(1) dhe nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (“KEDNJ”); nenin 9(1) dhe nenin 14(2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

26. Me gjithë formulimin e qartë të nenit 41(6) dhe standardet e ndryshme të parapara shprehimisht në tekstin e tij lidhur me secilin prej rreziqeve të identifikuar në nenin 41(6)(b)(i)-(iii), Gjykatësi i Procedurës Paraprake zbatoi një standard të njëzuar që kërkon një rrezik që është më shumë se i mundshëm, por më pak se i sigurt se do të materializohet.²³ Ky standard ka një spektër mjaft të gjerë. Në nivelin më të ulët, ai përfshin efektivisht çdo rrezik që *ka gjasa* – kundrejt që *mund* – të ndodhë, që ngërthen çfarë është e mundshme, ka gjasa, është e sigurt dhe çdo gjë tjetër në mes. Megjithatë, ky interpretim është në kundërshtim të plotë me kriteret e nenit 29(2) të Kushtetutës që kërkojnë rrezik të “konsiderueshëm” dhe që heqja e lirisë të jetë e “domosdoshme”, dhe nenit 5 të KEDNJ-së që kërkon rrezik “konkret” dhe “real”. Çka është me rëndësi, sa i përket rrezikut të pengimit të procedurave ose përsëritjes së veprës penale, standardi i zbatuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake është në mospërputhje me kriterin e shprehur qartë në nenin 41(6)(b)(ii), për të treguar arsye të artikulueshme për të besuar se i akuzuari “do të” pengojë procedurat, si dhe në nenin 41(6)(b)(iii) që kërkon një rrezik të përsëritjes së veprës që “do të” materializohet.²⁴

Arsyeja e tretë: Gabim në konstatimin se z. Shala paraqet rrezik për arratisje

27. Ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë pranoi se rreziku i arratisjes nuk mund të përcaktohet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit të mundshëm, në vlerësimin e tij ai vazhdoi të merrte parasysh aspekte të mangëta dhe të parëndësishme. Së pari, ai mori parasysh faktin që z. Shala nuk

²³ Vendimi i Kontestuar, paragrafët 16, 27, 28, 35, 40, 41.

²⁴ Shih nenin 41(6) (që përcakton se një i akuzuar mund të mbahet në paraburgim vetëm kur ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se ekziston rreziku se ai ose ajo *do të* [...] pengojë ecurinë e procedurës penale”; ose “[ekziston rreziku që] ai ose ajo *do të* përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose ai apo ajo do të kryejë ndonjë vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë (theksimi i shtuar).”

e pranon legjitimitetin e krijimit të DHSK-së,²⁵ pavarësisht faktit që z. Shala ka të drejtë ta bëjë këtë në kuadër të ushtrimit të të drejtave të tij për gjykim të drejtë.²⁶ Në këtë aspekt, “barazia e palëve dhe drejtësia më përgjithësisht peshojnë në favor të një shkëmbimi të lirë, dhe madje edhe të fuqishëm të argumenteve midis palëve.”²⁷ Neni 6 i KEDNJ-së nuk përcakton të drejtë të pakufizuar për të përdorur çfarëdo argumentesh për mbrojtje, veçanërisht për argumente që përbëjnë vepër penale. Kundërshtimi i z. Shala lidhur me legjitimitetin e DHSK-së qartazi nuk e arrijnë atë kufi. Z. Shala nuk mund të ndëshkohet ose të dënohet (duke u mbajtur në paraburgim) për deklarata të tilla. Për më tepër, posaçërisht kundërshtimet ndaj juridiksionit të DHSK-së lejohen sipas Rregullores së DHSK-së dhe përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të mbrojtjes së z. Shala.²⁸ Nxjerrja e përfundimeve në dëm të z. Shala gjatë vlerësimit të domosdoshmërisë së mbajtjes së tij në paraburgim, për shkak të deklaratave të tij mbi legjitimitetin e DHSK-së, përbën ndërhyrje të papërligjurore në të drejtën e z. Shala për të mbrojtur veten dhe do ta pengonte atë në ushtrimin e lirë të kësaj të drejte gjatë gjykimit, në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

28. Së dyti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh aspektin plotësisht hamendësues se z. Shala mund të marrë ndihmë nga një grup i vogël i pretenduar i anëtarëve të NKP-së të cilët mund të ndihmojnë njëri-tjetrin për t’u arratisur.²⁹

²⁵ Vendimi i kontestuar, para. 25.

²⁶ ECtHR/GJEDNJ, *Milijevic v. Croatia*, no. 68317/13, 25 qershor 2020, paragrafët 54, 55. “Kur është fjala për procedura penale ende të papërfunduara, duhet të merret parasysh e drejta e të gjithëve për gjykim të drejtë, sikurse garantohet në nenin 6 të Konventës.” *Shih gjithashtu, ECtHR/GJEDNJ, Brandstetter v. Austria*, 28 gusht 1991, Series A no. 211, para. 52.

²⁷ *Milijevic v. Croatia*, para. 54.

²⁸ Rregulla 97 e Rregullores.

²⁹ Vendimi i kontestuar, para. 26.

29. Neni 21(3) i Ligjit shprehimisht mbron të drejtën për t'u "konsideruar i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia përtej dyshimit të arsyeshëm". Në këtë kontekst, çdo kërkesë për lirim të përkohshëm duhet të shqyrtohet në bazë të së drejtës së personit të paraburgosur për t'u konsideruar i pafajshëm.³⁰ Mbështetja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në një hamendje të bazuar në një akuzë bazë kryesore të paraqitur në Aktakuzë, që ai duket se e pranon, është në mospërputhje me të drejtën e z. Shala për t'u konsideruar i pafajshëm. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse merret parasysh faza aktuale të procedurave dhe fakti që provat kundër z. Shala në mbështetje të kësaj akuze nuk janë dëgjuar ose kundërshtuar në gjykatë.
30. Së treti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh atë që ai e quan konteksti i përgjithshëm rreth çështjeve gjyqësore lidhur me UÇK-në që përfshinin shqetësime të "mirëprovuara". Lidhur me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake iu referua paragrafit 43 të vendimit mbi kërkesën e Hashim Thaçit për lirim të përkohshëm.³¹ Megjithatë, në atë vendim, pozita dhe roli i pretenduar i z. Thaçi brenda UÇK-së zuri vend të dukshëm në vlerësimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të kontekstit të përgjithshëm të çështjeve gjyqësore lidhur me UÇK-në.³² Rrethanat e z. Shala dallojnë konsiderueshëm nga rrethanat që u morën parasysh në atë vendim, veçanërisht duke pasur parasysh lidhjet e kufizuara të z. Shala me UÇK-në dhe faktin se ai u distanca plotësisht nga elita politike në Kosovë dhe nuk ka rrjet mbështetës. Është me rëndësi se Mbrojtja nuk ka qasje në argumentet dhe materialin mbështetës të ZPS-së në çështjen *Thaçi*, të cilat sidoqoftë nuk janë pjesë e materialeve në çështjen e z. Shala, dhe Mbrojtja nuk mund t'u përgjigjet atyre argumenteve në

³⁰ Vendimi i apelit të Veselit, para. 14; Aktvendim i DHSGJK-së, 26 prill 2017, para. 113.

³¹ Vendimi i kontestuar, para. 26, nr. 59 i referohet KSC-BC-2020-06, F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i redaktuar publik mbi vendimin për kërkesën e Thaçit për lirim të përkohshëm, 22 janar 2021 ("Vendimi i parë mbi paraburgimin lidhur me Thaçin").

³² Vendimi i parë mbi paraburgimin lidhur me Thaçin, para. 43, dhe referencat në shënimin 86.

mënyrë të njëmendtë dhe logjikisht as nuk mund të pritët nga ajo që ta bëjë këtë. Mbështetja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në parashtrime, aspekte dhe prova mbështetëse të tilla është një shkelje tjetër procedurale e nenit 5 të KEDNJ-së, sipas të cilit Mbrojtjes duhet t'i jepet mundësi reale dhe e efektshme për t'iu përgjigjur arsyeve mbi të cilat arsyetohet paraburgimi.

Arsyeja e katërt: Gabim në konstatimin se z. Shala do të pengojë procedurat

31. Vendimi i kontestuar konstatoi se ekziston rreziku që z. Shala do të pengojë ecurinë e procedurave para DHS-së. Ky konstatim u bazua në: (i) deklaratat e z. Shala lidhur me [REDAKTUAR], një dëshmitar i mundshëm i ngjarjeve mbi të cilat bazohen akuzat kundër z. Shala, të dhëna gjatë intervistës së z. Shala me policinë federale belge më 14 janar 2016; (ii) deklaratat e z. Shala të dhëna gjatë intervistës së tij me policinë federale belge më 14 janar 2016 dhe ZPS-në më 12 shkurt 2019 lidhur me z. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], z. [REDAKTUAR]; dhe (iii) dijeninë e z. Shala për faktin se z. [REDAKTUAR] ka dhënë dëshmi kundër tij.
32. Megjithatë, nuk ka prova se z. Shala ka ndikuar ose ka tentuar të ndikojë ndonjëherë, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, tek ndonjë dëshmitar, ose se ka tentuar në ndonjë mënyrë tjetër të ndërhyjë në material provues. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'i kishte shqyrtuar të gjitha rrethanat e çështjes aktuale dhe do të kishte zbatuar standardin e duhur, ai logjikisht nuk do të kishte nxjerrë përfundimin se ka arsye të artikulueshme të besohet se z. Shala do të pengojë procedurat.
33. Deklaratat e z. Shala iu referuan ngjarjeve që ndodhën para më shumë se 20 viteve, kur z. Shala u mor në pyetje nga autoritete hetimore si i dyshuar e jo si i akuzuar, në mungesë të një avokati. Rrjedhimisht, deklaratat e tij u dhanë në një kontekst abstrakt dhe lidheshin me personat nga të cilët ai ndihej i

kërcënuar, pa e ditur se persona të tillë do të ishin dëshmitarë kundër tij. Shprehja e armiqësisë së tij nuk mundet logjikisht të barazohet me synimin apo gatishmërinë për të ndërhyrë tek dëshmitarët në këto procedura.

34. Sa i përket dijenisë së z. Shala rreth dëshmisë së dhënë nga z. [REDAKTUAR], Mbrojtja vëren se, së pari, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabon kur i referohet përpjekjes së z. [REDAKTUAR] në 2015 për të pasur kontakt me z. Shala, si një “komunikim [që] ndodhi në 2015”.³³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh dhe nuk i dha peshën e duhur faktit që z. Shala refuzoi të merrte pjesë në *çfarëdo* komunikimi me dëshmitarin përkatës të propozuar dhe bllokoi plotësisht çdo komunikim me të. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu nuk mori parasysh se, ishte në fakt dëshmitari i propozuar që bëri përpjekje të vendoste kontakt me z. Shala e jo anasjelltas.
35. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur e konsideroi si të rëndësishme kohën e përpjekjes së pasuksesshme të z. [REDAKTUAR] për të kontaktuar z. Shala, duke vërejtur se kontakti i tentuar ndodhi kur z. Shala ishte i dyshuar e jo i akuzuar, si dhe kur supozoi se z. Shala do të kishte reaguar ndryshe pasi të merrte dijeni për Aktakuzën e konfirmuar dhe dëshminë e dhënë nga z. [REDAKTUAR] kundër tij. Megjithatë, ky supozim nuk konsideron mundësinë – që në fakt përputhet shumë më tepër me logjikën e shëndoshë si dhe me reagimin dhe dëshirën e prerë të z. Shala për të bllokuar çdo kontakt me z. [REDAKTUAR] – se statusi i z. Shala si i akuzuar do të ishte një arsye e konsiderueshme shtesë për të shmangur çdo kontakt me një dëshmitar të propozuar kundër tij.
36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur i dha peshë të konsiderueshme pretendimit, që nuk mbështetej në asnjë provë, se motivimi i z. Shalës për të ndërhyrë tek dëshmitarë të mundshëm u rrit automatikisht në momentin kur

³³ Vendimi i Kontestuar, para. 34.

ai u bë i akuzuar dhe kur iu bënë të njohura provat kundër tij të dhëna nga dëshmitarët e përmendur gjatë intervistave të tij. Në të njëjtën kohë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh faktin që z. Shala në të kaluarën ishte thirrur për t'u paraqitur si i dyshuar përpara autoriteteve hetimore belge (2016) dhe ZPS-së (2019). Gjatë intervistave të tij në 2016 dhe 2019, z. Shala u përball me akuza inkriminuese kundër tij të dhëna nga disa dëshmitarë, lidhur me përfshirjen e tij në ngjarjet mbi të cilat bazohet aktakuza. Kjo ishte në kohën kur ai merrej në pyetje si i dyshuar. Gjithashtu, dëshmitari i propozuar që përmendet në intervistën e janarit 2016, i kishte bërë akuzat kundër z. Shala, të cilat gjithashtu parashtrihen në Aktakuzën e Konfirmuar, gjatë dhënies së dëshmisë para Tribunalit Penal Ndërkombëtarë për ish Jugosllavinë ("TPNJ") në [REDAKTUAR]. Paarsyeshmëria e përfundimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me pretendimin për rrezik më të madh për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve si rezultat i ngritjes së akuzave kundër z. Shala, është gjithashtu e qartë nga fakti që z. Shala, për më shumë se dy dekada, ka pasur dijeni për pretendimet e hollësishme kundër tij nga autoritetet hetimore që kanë kompetenca për ta ndjekur penalisht dhe qëndrimi i tij i prerë ka qenë që të shmangë dhe të bllokojë të gjitha kontaktet me persona të përfshirë në ngjarjet që lidhen me akuzat kundër tij.

37. Mbrojtja parashtron më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i mori parasysh ose nuk trajtoi parashtrimin e Mbrojtjes lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve të propozuar me masa të shumta mbrojtjeje të miratuara deri tani, të cilat përfshijnë madje edhe anonimitetin e disa dëshmitarëve të caktuar në fazën aktuale. Edhe pse masat mbrojtëse si të tilla nuk mund të përjashtojnë të gjitha rreziqet e ndërhyrjes, ato duhet të merren parasysh si faktor lehtësues

që – së paku – duhej të ishin marrë parasysh nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.³⁴

Arsyeja e pestë: Gabim në konstatimin se z. Shala do të kryejë përsëri vepër penale

38. Në Vendimin e kontestuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekziston rreziku që z. Shala “do të” kryejë krime të tjera. Ky konstatim u bazua në përfundimet lidhur me rrezikun që z. Shala do të pengojë procedurat para DHS-së.³⁵
39. Ky përfundim është i mangët për shkak të faktit se u bazua në konstatimin e gabuar se ekziston rreziku që z. Shala do të pengojë procedurat. Z. Shala asnjëherë nuk ka kërcënuar se do të përdorë dhunë fizike kundër dëshmitarëve. Deklaratat e tij të mëparshme nuk duhet të nxirren jashtë kontekstit dhe logjikisht nuk mund të interpretohen se përbëjnë shprehje të vullnetit për të përdorur dhunë kundër viktimave dhe dëshmitarëve.³⁶
40. Gjithashtu, nuk ka absolutisht asnjë provë që z. Shala ka rrjet mbështetës ose aftësi të krijojë ose mobilizojë ndonjë mbështetje. Baza e pretendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të kundërtën nuk ka asnjë bazë dhe duket arbitrare.³⁷ Z. Shala u largua nga Kosova më shumë se 20 vjet më parë dhe u distanca plotësisht nga ngjarjet që kanë ndodhur në Kosovë në dy dekadat e fundit. Ai asnjëherë nuk ka mbajtur ndonjë funksion publik ose pozitë me pushtet në Kosovën e pas luftës. Siç e ka theksuar edhe z. Shala në

³⁴ ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-PT, Vendim mbi mocionin e Ramush Haradinajt për lirim të përkohshëm, 6 qershor 2005, para. 49.

³⁵ Vendimi i kontestuar, para. 39.

³⁶ 066866-066882-ET Rishikuar RED, f. 9 (066876).

³⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 39.

disa raste, ai i ka shkëputur të gjitha lidhjet me Kosovën dhe nuk ka asnjë lidhje me elitat e saj politike.

Arsyeja e gjashtë: Gabim në vlerësimin e kushteve të mundshme për lirim

41. Vendimi i kontestuar konstatoi se nuk ka kushte që mund të lehtësojnë rrezikun e pengimit të ecurisë së procedurave përpara DHS-së dhe kryerjeve të krimeve të tjera, sepse kufizimet e vendosura ndaj z. Shala nuk mund të "kufizojnë aftësinë e z. Shala për të pasur qasje në informacion dhe burime që do të lehtësonin çdo përpjekje për të komunikuar me viktimat, familjet e tyre dhe rrjetin e tij mbështetës."
42. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim konsideroi se "moria e mjeteve të komunikimit është aq e shumëllojshme sa që vetëm nëpërmjet kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së, komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në mënyrë të efektshme." Mbrojtja parashtron se asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do të kishte nxjerrë përfundimin se nuk ekzistojnë mjete për të monitoruar komunikimin privat të z. Shala në mënyrë të efektshme në rast të lirit të përkohshëm ose arrestit shtëpiak. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori në shqyrtim si duhet kushtet e përcaktuara në nenin 41(12) të Ligjit, lidhur me kufizimet ose monitorimet e komunikimeve private, që ndalojnë z. Shala të kontaktojë persona të caktuar; që kërkojnë nga ai përdorimin e mjeteve të caktuara të cilat mundësojnë monitorimin ose kufizimin e thirrjeve të tij telefonike. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu nuk mori në shqyrtim si duhet kushtin e propozuar të ndalimit të qasjes, ose qasjes së kufizuar në internet dhe qasjes në një telefon të vetëm mobil për qëllime të kufizuara të komunikimit, si komunikimi me ekipin e mbrojtjes së z. Shala. Këto kushte të

përcaktuara në nenin 41(12) janë përfshirë për një arsye; ato nuk duhet të hidhen poshtë si të paefektshme aq lehtë.

43. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideroi se “duke jetuar në një vend ku shqipja nuk është gjuhë zyrtare, monitorimi i çdo komunikimi të z. Shala në këtë gjuhë, sidomos kur përdor gjuhë të koduar apo të pakuptueshme, do të paraqiste pengesa të konsiderueshme”.³⁸ Mbrojtja parashtroi se banimi i z. Shala në Belgjikë nuk duhet të konsiderohet faktor kundër tij, [REDAKTUAR]. Çka është më me rëndësi, nuk mund t’u jepet rëndësi shpenzimeve të mundshme për përkthim lidhur me komunikimin e mundshëm të z. Shala në shqip, gjatë peshimit të këtyre aspekteve kundrejt së drejtës së z. Shala për lirim të përkohshëm në pritje të gjyqimit, që mishërohet në nenin 5 të KEDNJ-së dhe nenin 29 të Kushtetutës së Kosovës.

Arsyeja e shtatë: Gabim në vendosjen e një “ndalimi të përgjithshëm” mbi lirin e përkohshëm për shkak të shqetësimeve lidhur me mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit të nxjerrë

44. Në mungesë të ndonjë prove ose treguesi apo shqetësimi konkret lidhur me keqpërdorimin e mundshëm nga z. Shala të komunikimit privat për të penguar procedurat, arsyeja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake përbën në fakt një ndalim të përgjithshëm mbi lirin e përkohshëm. Ai u heq të gjithë të akuzuarve çfarëdo shprese për lirim të përkohshëm, pavarësisht rrethanave. Ai është në mospërputhje me nenin 41(6) të Ligjit dhe nenin 5 të KEDNJ-së që garantojnë të drejtën e lirit në pritje të gjyqimit. Gjithashtu ai nuk përputhet me prezumimin e pafajësisë që garantohet në nenin 6(2) të KEDNJ-së. Nuk ka asnjë provë para DHS-së që z. Shala ka përdorur ndonjëherë komunikimin privat për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, megjithëse ka pasur dijeni për pretendimet kundër tij tash e sa vite, si dhe për mundësinë e ndjekjes penale

³⁸ Po aty, para. 47.

bazuar në to. ZPS-ja nuk treguar ekzistencën e ndonjë rreziku konkret në këtë aspekt. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të vendosë ndalim të përgjithshëm për shkak të shqetësimeve lidhur me monitorimin e komunikimit të një të akuzuari dhe për shkak të frikës plotësisht hipotetike të nxjerrjes së informacionit palëve të treta. Jurisprudenca ekzistuese e KEDNJ-së përcakton se ndalimet e përgjithshme janë në mospërputhje me parimin e proporcionalitetit.³⁹

Arsyeja e tetë: Vlerësim i gabuar i proporcionalitetit të paraburgimit

45. Në vendimin e kontestuar, pasi u identifikua ekzistenca e rreziqeve të caktuara, nuk u analizua proporcionaliteti i paraburgimit kundrejt rëndësisë së prezumimit të pafajësisë dhe të drejtave të z. Shala për liri dhe mbrojtje të jetës së tij familjare. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk u përpoq të gjente drejtpeshimin e duhur midis aspekteve të ndryshme themelore në fjalë.
46. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur e kufizoi vlerësimin e tij të proporcionalitetit të paraburgimit vetëm në marrjen parasysh të kohëzgjatjes së paraburgimit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara të KEDNJ-së.⁴⁰

Arsyeja e nëntë: Mosvlerësimi i propozimit të z. Shala për vendosje në arrest shtëpiak

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh aspak propozimin për ta vendosur z. Shala në arrest shtëpiak në vendin e banimit të tij në Belgjikë, të cilin Mbrojtja e paraqiti si alternativë ndaj paraburgimit.

³⁹ ECtHR/GJEDNJ, *Dickson v. the United Kingdom* [GC], no. 44362/04, ECHR/KEDNJ 2007-V, para. 84, 85; ECtHR/GJEDNJ, *Hirst v. the United Kingdom (no. 2)* [GC], no. 74025/01, ECHR/KEDNJ 2005-IX, para. 82.

⁴⁰ ECtHR/GJEDNJ *McKay v. the United Kingdom* [GC], no. 543/03, ECHR/KEDNJ 2006-X, paragrafët 41-45.

V. MASA E KËRKUAR

48. Për këto arsye, konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake cenohen nga gabime të rënda faktike dhe ligjore si dhe nga ushtrimi i padrejtë dhe i paarsyeshëm i diskrecionit, që kanë ndikuar thelbësisht në vendimin e kontestuar. Mbrojtja me respekt kërkon nga Paneli i Gjykatës së Apelit që të:

- a) **PRAPËSOJË** vendimin e kontestuar; dhe
- b) **MIRATOJË** kërkesën për lirim të përkohshëm në bazë të kushteve që Paneli i konsideron të domosdoshme dhe të përshtatshme.

Parashtruar me respekt,

/nënshkrim/

Zhan-Lui Zhilisen
Mbrojtës i Specializuar

/nënshkrim/

Hedi Auini
Bashkëmbrojtës

E hënë, 31 gusht 2021

Në Hagë, Holandë

Numri i fjalëve (në origjinal): 5556